



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:191217
Datë: 07.05.2024
Numri i dokumentit: 05662684

Ac.nr.8935/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses F. G. nga Vushtrria, të cilën në bazë të autorizim e përfaqëson N. S., avokat në Prishtina, kundër të paditurës KS “E.” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson E. A., objekti i kontestit kompensim i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, si dhe të paditurës kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm, me numër C.nr.734/15 i datës 02.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht e themeltë ankesa e paditëses F. G. nga Vushtrria, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.734/15 i datës 02.04.2021, në pikën I të dispozitivit që i referohet shumave të gjykuara në emër të frikës, dhe kompensimit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ku gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, që paditëses F. G., në emër të kompensimit të dëmit jo material për shkak të frikës t’ia paguaj shumën prej 2.400€, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, t’ia paguaj shumën prej 2.500€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar për këto kategori të dëmit REFUZOHET SI E PABAZUAR.

- II. APROVOHET** pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurime “E.” sh.a., me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.734/15 i datës 02.04.2021, në pikën I (një) të dispozitivit lidhur me dëmin jo material për kompensimin lidhur me dhimbjet fizike ashtu që gjykohet: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurime “E.”

sh.a., me seli në Prishtinë, që paditëses F. G. nga Vushtrria, në emër të kompensimit për shkak të dhimbjeve fizike t'ia paguaj shumën prej 2400€, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë, përtej shumës së gjykuar për këtë kategori të dëmit REFUZOHET SI E PABAZUAR.

III. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar ankesa e paditëses F. G. nga Vushtrria dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.” sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.734/15 i datës 02.04.2021, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin e atakuar C.nr.734/15 i datës 02.04.2021, ka vendosur si në vijim: Aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditëses F. G. nga Vushtrria, DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 19.01.2015, t'ia paguajë shumat e specifikuar si më poshtë: Dëmi jo material: Në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,700.00 euro, Në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2,200.00 euro, Në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,000.00 euro, Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 2.000.00 euro. Dëmi material: Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 300.00 euro, Në emër të ndihmës nga personi i tretë 300.00 euro, Në emër të shpenzimeve të mjekimit shumën prej 106.00 euro. II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.”, me seli në Prishtinë, që paditëses për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë t'ia paguaj kamatën në lartësi prej 12%, duke filluar nga data 02.04.2021, dita kur është nxjerr aktgjykimi, e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,013.00 Euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimin e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë: në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1,300.00 Euro, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar shumën prej 800.00 Euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,000.00 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 6,000.00 Euro, në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej 20.00 Euro dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik, shumën prej 600.00 Euro, SI E PA BAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë dhe atë për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për sa i përket lartësisë së kompensimit, shpenzimeve të procedurës, si dhe llogaritjes së kamatës.

Po ashtu kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i të paditurës dhe atë për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shpenzimet e procedurës, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e të paditurës, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që pjesën e gjykuar t'ia zvogëloj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e paditësit dhe e të paditurës janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse përmes të autorizuarit të saj në gjykatën e shkallës së parë me datën 27.03.2015, ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, për kompensimin e dëmit material dhe jo material. I autorizuari i paditëses në padi ka theksuar se me datën 19.01.2015, rreth orës 18:45, në Vushtrri, në të cilin lëndime trupore ka pësuar paditësja. Deri te aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit nën A, me targa 02-...-..., i cili duke lëvizur në mënyrë të pasigurtë, me pjesën e përparme të automjetit e godet automjetin B, ku përveç dëmeve materiale ju shkakton lëndime trupore personave në automjetin B, si pasojë e kësaj, paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Pas nxjerrjes së ekspertizave mjekësore, përfaqësuesi i paditëses ka bërë precizimin e padisë në kuptim objektiv. Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses.

Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë vlerësimin se nga provat e administruara është vërtetuar se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur më datën 19.01.2015, rreth orës 18:45, në Vushtrri dhe deri te aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit nën A, me targa 0...-B., i cili duke lëvizur në mënyrë të pasigurtë, me pjesën e përparme të automjetit e godet automjetin B, me targa të regjistrimit ..-KS-, me ç’rast tani paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Gjykata vlerësoi se, të paditurën e bënë përgjegjëse për kompensimin e dëmit ndaj paditësit, pasi që shkakuesi i dëmit ka të lidhur kontratë me të paditurën dhe në këto rrethana kompensimi bëhet mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë (sigurimit të detyrueshëm për palët e treta) konform nenit 136 dhe 159 par. 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Për të vërtetuar rrethanën se paditësja ka pasur lëndime trupore, gjykata u bazua nisur nga raporti nga QKUK, Qendra Emergjente në Prishtinë, me nr. të protokollit 2499 i dt.19.01.2015, Ekspertiza mjekësore të dt.08.10.2020, punuar nga Dr. N. D. ortoped-traumatolog dhe Dr. B. O. –psikiatër dhe Specifikacioni i shpenzimeve të mjekimit i dt.18.02.2021. Ekspertët mjekësor Dr.N.D. ortoped-traumatolog dhe Dr.B.O. psikiatër, në ekspertizën mjekësore të dt.08.10.2020, pas ekzaminimeve përkatëse kanë ardhur në përfundim se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë: Thyerje e urezes së djathtë, qarje e fibules së majtë, shtypje e krahut të djathtë, shtypje e unazave të qafës dhe shtypje e kercirit të majtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në lëndime të rënda trupore. Shëmtimi trupor ka pasur të shkallës së ulët – shih cikatrishin dhe shtypjen e mbetur të kockës frontale djathtas pas lëndimit në regjionin ballor djathtas në diametër 1x1 cm. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është në shkallë prej 5%, dhe atë duke u bazuar në tabelat e klasifikimit të lëndimeve trupore të aprovuar nga BQK dhe të miratuar nga ana e MSH më datë 13.01.2016 me nr.05-201. Në kuptim të

dispozitave materiale, gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitave nga neni 183 i LMD-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat i njëjti është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par. 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë, përveç pjesës së ndryshuar, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe ajo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Gjykata Apelit nuk është lëshua në analizë më të zgjeruar sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, për ndër gjyqësit nuk ishte kontestuese përgjegjësia në dëmin e shkaktuar, gjithashtu nuk kishte pretendim ankimor për këtë pjesë. Për sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, Gjykata e Apelit pranoi pjesërisht pretendimet ankimore të paditëses, sa i përket lartësive të shumave të kompensimit, të caktuara nga gjykata e shkallës së parë, për format e dëmit jo material për frikën e përjetuar dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor, të cilat janë vërtetuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Për sa i përket pretendimeve ankimore të palëve ndër gjyqës në lidhje zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit vlerësojë se në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit në relacion me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë gabimisht është zbatuar e drejta materiale. Fakti se paditësja kishte pësuar lëndime të natyrë së rëndë, është vërtetuar edhe nga ekspertizat mjekësore, kurse lidhur me këtë neni 183 par. 2 të LMD-së, përcakton *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror“.*

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I (një) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategorinë e dëmit jo material, lidhur me zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë pasi që vlerësoj se shumata e gjykuar nuk ishte në harmoni me shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë prej 5%, pasi që shumata e gjykuar ishte e ulët dhe në shpërputhje më qëllimin e kompensimit dhe me standardin

e praktikës gjyqësore. Në këtë kuptim duke e marrë parasysh shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, si pasojë e lëndimit të dorës dominante, po ashtu praktikën gjyqësore për këtë kategori të dëmit, vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Po ashtu kjo gjykatë vendosi si në pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategorinë e dëmit jo material, lidhur me frikën e përjetuar pasi që vlerësoj se shuma e gjykuar nuk ishte në harmoni qëllimin e kompensimit për dëmin jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarën. Shuma e gjykuar për frikë ishte e ultë dhe në shpërputhje me kategoritë tjera të dëmit dhe rrjedhimisht edhe me praktikën gjyqësore. Gjykata e Apelit duke vendosur për frikën mori në konsideratë llojin, intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar e konstatuar nga eksperti i psikiatrisë i cili ka vlerësuar se paditësja ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekondash, e cila frikë është përcjellur me ndjenjën se tani ka përfunduar gjithçka dhe ky është fundi i saj i jetës, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur rreth 2 orë, frikë sekondare të intensitetit mesatar ka zgjatur rreth 3 muaj, kurse frikë sekondare të intensitetit të ulët ka edhe sot, duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera si moshën e paditëses, praktikën gjyqësore vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II (dy) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për kategorinë e dëmit jo material, lidhur me dhimbjet fizike pasi që vlerësoj se shuma e gjykuar nuk ishte në harmoni qëllimin e kompensimit për dëmin jo material e që është satisfaksion dhe asesi qëllime tjera që do të binin ndesh me qëllimin e kompensimit për dëmin jo material. Kjo gjykatë vlerësoi se rastin e caktimit të shumës kompensuese për këtë kategori dëmi duhet të merret parasysh natyra e lëndimit, pasojat, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike. Kjo do të thotë se për këtë kategori të dëmit jomaterial është zbatuar gabimisht e drejta materiale për të cilën gjykata e shkallës së dytë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 ë LPK-së, prandaj aktgjykimi i goditur në këtë pjesë ndryshohet në bazë të nenit 201 par.1 pika d) e LPK-së, ashtu që paditëses në emër të dhimbjeve fizike trupore i pranohet shuma në vlerë prej 2400€. Përveç kësaj, në rastin konkret është shkalla e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë e klasifikon lëndimi si të rëndë trupor dhe në këtë rast gjykata e shkallës së parë kishte gjykuar kompensim për dhimbjet fizike më të lartë se vet kompensimi për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë. Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë përtej shumës së aprovuar për këtë kategori të dëmit gjykata vlerësoj se kërkesëpadia nuk ishte në harmoni me qëllimin e kompensimin për dëmin jo material.

Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën III (tretë) të dispozitivit të aktgjykimit duke e vërtetuar aktgjykimin në pjesën e kërkesëpadisë për dëmin material në emër të ushqimit të përforcuar, ndihmës nga personi i tretë, shpenzimeve të mjekimit, po ashtu për dëmin jo material për dhimbjet shpirtërore për shkak të shëmtimit.

Për dëmin material lidhur me shpenzimet e shërimit gjykata vendosi ta vërtetojë aktgjykimin e ankimuar sepse shumat e gjykuar është në harmoni me shpenzimet e prezantuara përmes faturave-kuponëve. Është vërtetuar se paditësja si pasojë e lëndimit që kishte pësuar, ka pasur shpenzime që justifikojnë lartësinë që ka njohur gjykata e shkallës së parë.

Kjo gjykatë i vlerëson reale shumat e gjykuara me këtë aktgjykim e që kanë të bëjnë me kompensimin e dëmit material në emër të përkujdesjes së personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, kjo duke marrë për bazë kohëzgjatjen nevojës për përkujdesjen e personit të tretë prej 2 muajve, siç është konstatuar nga eksperti ortoped, si dhe ushqimin e përforcuar të konstatuar në kohëzgjatje prej 3 muajve, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh raste të tilla të kompensimit. Duhet të pasur parasysh fakti se për këto kategori të dëmit material në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshin ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo pasi që paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të konstatuar në ekspertizë për paditësen), asaj ligjërisht i takon ky lloji dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara. Kjo gjykatë vlerësoi si të drejtë mënyrën e vendosjes nga gjykata e shkallës së parë edhe për sa i përket shëmtimit, ngase nga gjendja faktike e vërtetuar drejtë, është konluaduar se paditësja kishte shkallë të ulët të shëmtimit, prandaj shumat e aprovuar është e justifikueshme.

Për dëmin jo material për të cilin është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë, Gjykata e Apelit vlerësoi se në çdo rast për dëmin jo material gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i shkoj përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material, e që është satisfaksion për palën e dëmtuar.

Gjykata Apelit vlerësoi si të pa bazuar pretendimin ankimor të të paditurës për sa i përket mënyrës së llogaritjes së kamatës nga gjykata e shkallës së parë, kjo ngase sipas nenit 26 par. 2 të Ligjit NR.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, “ *Nëse kërkesa e parashtruar nuk është e kompletuar me prova dhe dokumentacion të nevojshëm për të vendosur për dëmshpërblimin, siguruesi është i detyruar që, më së largu në afat prej tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për dëmshpërblim, të njoftojë me shkrim të dëmtuarin duke precizuar me cilat nga provat dhe dokumentacioni duhet plotësuar kërkesën...*”. Nga shkresat e lëndës, është gjetur se realisht e paditura ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë, ashtu që përgjigja e ofruar nga e paditura sipas kërkesës për kompensim të paditëses, nuk ishte refuzuese, porse kërkohej dokumentacion shtesë, dhe i ishte dërguar të autorizuarit të paditëses pas kalimit të afatit tre ditor. Rrjedhimisht përcaktimi i gjykatës së shkallës së parë se në këtë rast lartësia e kamatës duhet të jetë në lartësi 12%, është e drejtë.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale, Gjykata e Apelit e ka vërtetuar vendosjen e shkallës së parë lidhur me to, meqenëse i njëjti vendim, është mbështetur në nenin 452.1 dhe 463 të LPK-së.

Bazuar në vlerësimet e dhëna deri tani, rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
Ac.nr.8935/21, me datë 07.05.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli